



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31010-07816-80-2016 **Data e Regjistrimit :** 04/10/2016
Numri i Vendimit: 80-2016-6062 **Data e Vendimit :** 15/12/2016

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 15/12/2016 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Subjekti "{...}" I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave.

Objekti:Shfuqizimi i aktit administrativ Vendim nr. 774/7, date 15.12.2014, njoftuar me date 07.09.2016, i Bordit te Apelimit te Drejtonse se Pergjithshme te Patentave dhe Markave; Detyrimin e te paditurir per rregjistrimin e markes "{...}" sipas aplikimit AL/T/2013/774 me aplikant Z.

Baza Ligjore:Neni 7,11,15/a, i Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", Kodi i Procedurave Administrative, Neni 143,152 dhe 153 i Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" . mosmarreshjeve administrative", Kodi i Procedurave Administrative, Neni 143,152 dhe 153 i Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" .

Gjykata pasi administroi provat e paraqitura dhe shqyrtoi kerkese padine

VEREN :

Vereni Se palapaditese, I eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me kerkese padi meobjekt:
"Shfuqizimi i aktit administrativ Vendim nr.774/7, date 15.12.2014,njoftuar me date 07.09.2016, iBordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave;

Detyrimin e te paditurit per rregjistrimin e markes "{...}" sipas aplikimit AL/T/2013/774 meaplikant Z. {...}..."

Perparashqyrtimit te bazuesmerise ne ligj e ne prova te kerkese padise, gjykataanalizoi juridiksionin dhe kompetencen e saj ne gjykimin e kesaj geshtje. Ne baze te neneve 7, 8, 10, 11 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimindhefunksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeveadministrative" gjykata konstatoi se geshtja hyn ne juridiksionin gjyqesor dheeshte ne kompetencen lendore e tokesore te Gjykates se Shkalles se PareAdministrative Tirane.

Lidhur me kompetencen lendoreGjykata iu referua praktikese gjyqesore te Gjykates se Larte e e cila mevendimin nr 2236 date 25.05.2016 ka argumentuar se:

"Ne geshtjen objekt shqyrtimi rezulton sepala paditese kundershon aktin administrativ, vendimin me Nr. 8/6 Prot., date 05. 11. 2015 te Bordit teApelimit te Drejtorise se Patentave dhe Markave, i cili eshte nje organadministrativ. Pavaresisht se, ne kete gjykim kerkimet e paditesit dhe shkakuligjor ku ai mbeshtet keto kerkime, i perkasin te drejtave qe mbrohen ngakuadri ligjor per pronesine industriale, paditesi te drejtat e tij tepretenduara te shkelura kerkon t'i mbroje me ane te kundershimit te aktitadministrativ te nxjerre prej nje organi publik. Shkaku i padise, veprimi qepala paditese pretendon se ka shkaktuar shkeljen e te drejtave te paditesiteshte vendimi Nr. 8/6 Prot., date 05.11.2015 i Bordit te Apelit te Drejtorise se Markave dhe Patentave. Ne keto kushte perderisa shkaku imosmarreveshjes eshte veprimi i organitte administrates publike, atehere eshte e qarte qe mosmarreveshja eshte efushes administrative. E per rrjedhoje gjykata kompetente nga pikepamja lendoreeshte gjykata administrative.

Kolegji Civil i Gjykates se Larte, ne referim te nenit 11, prg. 1 dhe 5 te Ligjitnr.49/2012, vlereson se edhe nga pikepamja territoriale kjo mosmarreveshjeeshte ne kompetencen e Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, perarsye se ne geshtjen objekt gjykimi kundershohet nje vendim i Bordit teApelimit te Drejtorise se Patentave dhe Markave, qe e ka seline ne Tirane (neni42 i K.Pr.Civile). ... " Gjate hetimitgjyqesor rezultoi se :

Paditesi{...} eshte nje subjekt tregtar i sedrejtshqiptare i rregjistmar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPTL13523401T, me objekt te aktivitetit te tij tregtar ne fushen hoteleri.Kyaktivitet ushtrohet ne qytetin e Fierit.

Ne date31.12.2013 paditesi ka depozituar prane Drejtorise se Pergjithshme te Patentavedhe Markave kerkesen per rregjistrimin e markes, per mallrat e klases 43 teKlasifikimit te Nises, konkretisht per :*Sherbimeper sigurimin e ushqimeve dhe pijeve, strehim i perkohshem.*

Pasi aplikimi eshte depozituar ngapala paditese prane pales se paditur ka publikuar ne Buletinin e Markave teDrejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave, me nr.2, date 09.04.2014pamjen e markes se paditesit "{...} {...}" se bashku me te dhenat eplota te aplikimit si dhe klases 43 te markes ne perputhje me klasifikimin eNises.

Me shkresen nr.774/5, date 18.08.2014te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave paditesi eshte njoftuar prane ketij institucioni eshte rregjistruar nje kerkese per kundershimitin erregjistrimit te markes se publikuar me te dhenat perkatese (marka e kerkuarper rregjistrim nga paditesi) duke e njoftuar paditesit per te drejten e tijper te paraqitur pretendimet me shkrim lidhur me kerkesen per kundershimitin erregjistrimit te markes si dhe cdo dokument tjeter qe sherbente si prove per tembeshtetur kerkesen e tij per rregjistrim. Kundershitesi I rregjistrimit te markeseshte personi I trete Shoqeria {...} shpk e cila ushtron aktivitetin e saj neqytetin eTiranes.

Pala Paditese pasi ka marre dijeniper kundershimitin e depozituar ne perputhje me nenin 152 te Ligjit Nr.9947 pika1 te saj ka paraqitur pretendimet e tij lidhur me kerkesen per kundershimitin ecila I referohej nje ngjashmerie te markes se rregjisitruar prane DPPM-se ngapersoni I trete.

Ne pritje te shqyrtimit te kesajkerkese dhe vendimit te Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme tePatentave dhe Markave, paditesi ka zhvilluar aktivitetin e tij tregtar i cilindodhet ne qytetin e Fierit dhe per nje periudhe kohe shume te gjate nuk kamarre asnje vendim lidhur me kerkesen e tij per rregjistrim dhe lidhur mekerkesen e paraqitur nga subjekti tjeter per kundershimitin e rregjistrimit.

Ne date07.09.2016 paditesi eshte njoftuar me Vendimin nr.774/7, date 15.12.2014 teBordit te Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave icili ka vendosur :

"Pranimin e kundershimitit ndaj rregjistrimitte markes me numer aplikimi AL/T/2013/774 me aplikant {...} dhe refuzimine rregjistrimit te saj.

Te drejten e ankimit ndaj ketij vendimi ne gjykate brenda 30 diteve ngamarrja dijeni.

Sipas vendimit te Bordit te Apelimitne perputhje me nenin 153 pika 1,2,3 eshte konkluduar se kerkesa e depozituateshte ne perputhje me Ligjin nr. 9947 neni 143 „Refuzimi per shkaqe relative“pika 2 (b) marka e ne proces rregjistrimi nga pala paditese ka konflikt me tedrejta te mepareshme pasi:

Ka ngjashmeri memarken e rregjistruar me pare nga personi 1 trete,

Ka ngjashmeriper shkak te sherbimit qe ofron duke sjelle per pasoje konfuzion tekonsumatori.

Nevendim arsyetohet se:

" meqenesemarka e kundershitar kerkon mbroitie per te njejtat mallra per te cilat eshtembrojtur marka e meparshme. ngjashmeria mes tyre krijon mundesine e shkaktimitte konfuzionit te konsumatori. perfshire edhe mundesine e bashkelidhjes mestyre. Bordi i Apelimit arrin ne konkluzionin, se aplikimi per regjistrimin emarkes me numer aplikimi AL/T/2013/774 shkel te drejtat e meparshme te markesme nr.

10088 regjistrimi ne kuptim te nenit 143 pika 2 te Ligjit Nr. 9947 date07.07.2008 "Per Pronesine Industriale"

Pala paditese ka pretenduar se vendimi i pales se paditur eshte pambeshtetur ne ligj dhe i eshtedrejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Administrative Tirane me kerkese padineobjekt gjykimi.

OPala paditese pretendoi se:

•Vendiminr.774/7, date 15.12.2014 i Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme tePatentave dhe Markave eshte nje vendim i mare ne kundershimit me ligjin dhe singa ana materiale ashtu dhe procedurale dhe si i tille duhet te shfuqizohetnga Gjykata. Ligji nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" ka siobjekt te tij rregullimin e sistemit te dhenies dhe te mbrojtjes se te drejtavete pronesise industrial, objket i te edit jane edhe markat tregtare dhesherbimet.

•Meqellim zbatimin e ketij objekti ne kete ligji jane percaktuar procedurat dheafatet procedurale per rregjistrimin e nje marke si dhe ato per kundershitimine rregjistrimit te nje marke. Konkretisht ne kreun XXIV te ketij ligjipercaktohet procedura e rregjistrimit te markes, dhe ne nenin 145 percaktohetkushtet qe duhet te permbush nje aplikat per rregjistrimin e markes qe ajo tekonsiderohet e pranuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave.

•Pala e paditur ne kundershimit me dispozitat ligjore dhe afatet e percaktuara ne te,ka pranuar kerkesen e paraqitur jashte afatit ligjor per kundershimitin erregjistrimit te markes sone, here prej nje subjekti tjeter, personi i trete nekete gjykim . Pasi apkkim eshte publikuar ne date 09.04.2014 dhe kerkesa perkundereshtim duhet te dcpozitohcj brncda 3 muajve nga data e publikimit neperputhje me Nenin 152 pika 1

e Ligjit nr.9947 pra brenda dates 09.07.2014. Kerkesa e cila ne aspektinformal dhe ne perputhje me ligjin dhe rregulloren e markave duhet te perfshije,Formular aplikimi per kundershimit, pagesen e tarifes per kundershimit 7000(leke) shpjegime dhe provat per kundershimit. •Ne rastin objekt gjykimi kerkesa per kundershimitin e markes ne proces aplikimi ngaana e personit te trete, eshte paraqitur dhe pranuar ne Drejtorine e Pergjithshme te Patentave dhe Markave ne date 16.07.2014, nderkohe qe publikimieshte here ne date 09.04.2014, pra kerkesa eshte paraqitur jashte afatit ligjortremujor, sikurse e percakton ligji pasi ligji percakton brenda peridhes 3 (tre) mujore kerkesa duhet te depozitohet brenda dates 09.07.2014,

•Prapala e paditur ne kundershimit me dispozitat ligjore ka pranuar dhe ka shqyrtuarne kerkese per kundershimit rregjistrim marke jashte afatit te percaktuar neligj, veprim i kundraligjshem i cili nuk mund te sjelle pasoja te ligjshme.

afatit te percaktuar neligj, veprim i kundraligjshem i cili nuk mund te sjell pasoja te ligjshme.

- Nga ana tjetër ligji parashikon ne nenin153 te tijse "Bordi i apelimit shqyrtton kundershhtimin brenda nje periudhetremujore nga data e paraqitjes se tij dhe njofton palet per vendimin e marre".
- Praligji ka percaktuar nje afat kohor Brenda se ciles I padituri ka detyriminligjor te shqyrtoje kundershhtimin e markes dhe te dale me nje vendim lidhur mekete kerkese dhe tia njoftoje paleve te interesuara ne kete procedimadministrative. Ne rastin konkret Bordi i Apelimit jo vetem qe nuk e kashqyrtuar kerkesen e kundershhtimit brenda periudhes ligjore tremujore nga ditae kundershhtimit, por as nuk e ka njoftuarpaditesin ashtu sikurse kerkon ligj.
- Sikurseciatua me lart dhe provohet nga dokumentacioni qe do te paraqesim perpara Gjykates, kerkesa per kundershhtimin e markes eshte rregjistruar ne DPPM ne date16.07.2014, qe do te thote se Bordit duhet te kishte shqyrtuar dhe marrevendimin ne date 16.10.2014 qe i perket periudha tre mujore. Jo vetem qe kyafat nuk eshte rcspektuar, por nga I padituri nuk eshte respektuar as detyriminligjor per venien ne dijeni te subjektit te interesuar per vendimin e marre. Vetempas dy vjetesh I padituri ka njoftuar paditesin per vendimin e marre, vendim kyqe sjell shume pasoja per paditesin.
- Sikursekonstatohet qarte veprimet administrative te te paditurit vijne ne

kundershhtim jo vetem me dispozitat epergjithshme te percaktuara ne Kodin e Procedurave Administrative por edhe nekundershhtim me dispozitat e posacme te percaktuara ne ligjin materialnr.9947/2008 per pronesine industrial. Nje akt administrativ fillon te sjellepasoja juridike ndaj pales se ciles i drejtohet apo interesat e se ciles prekennga akti, me njoftimin e permbajtjes se aktit paleve.Ne rastin konkretepaditesit ky vendim i eshte komunikuar nga i padituri pas dy vjetesh nga marrjae tij.

- Jo me kot ligjvenesi ka percaktuar afatekohore brenda se ciles organi administrativ duhet te nxjerre aktetadministrative dhe tia komunikojte paleve se interesuar ne procedimadministrative. Respektimii ketyre afateve ligjore te percaktuara eshte shume i rendesishem per palet ne procedim administrative, pasi nga mosrespektimi I ketyre keto afateve vijnepasoja per te.Kodi i procedurave administrative i ka klasifikuar te pavlefshmeaktet administrative qe jane marre ne kundershhtim me proceduren ligjore tepercaktuar nga ligji. •Pretendimii te paditurit se duke patur ngjashmeri fonikc ekziston rreziku i konfuzionite konsumatori nuk qendron per disa arsye. Marka jone eshte kompleks i fjaleve{...} {...}, ndersa marka kundershhtuese eshte vetem {...}.
- Gjithashtuper vete natyren e biznesit ngjashmeria fonike nuk mund te sjelle asnjekonfuzion tek konsumatori, pasi biznesi i paditesit eshte ne nje zone tjetër jone Tirane ku ndodhet marka kundershhtuese dhe cdo kush qe do te shkoj tepaditesi se pari nuk do te shkoje pasi e konfondon me {...}in ne Tirane porper shkak te nevojës dhe se dyti nuk mund te konfondohen pasi nga ana vizualejane shumc te ndryshme dhe per cdo njeri qe e shikon ate nuk ekziston asnjemundesesi konfuzioni ngaterrimi me ate te markes kundershhtuese. Markakundershhtuese eshte vetem me fjalen {...} qe ka perpara saj nje elementfigurative nje burre me kapele te ulur, ndersa marka jone eshte vetem cmer{...} {...}dhe ka si element figurative nje glob me germen M te madhne mes.
- Prane pamje vizive ato jane shume te ndryshme nga njera tjetra dhe nje klient doti dallonte shume mire njera nga tjetra. Neni 143i ligjit percakton se markanuk mund te rregjistrohet kur ajo eshte e njejtme me nje marke tjetër terregjistruar me pare dhe ne rastin konkret nuk kemi te bejme me marka te njejtane aspektin pamor (vizual).Persa me siper kemi shpjeguar akti administrativevendimi nr.774/7, date 15.12.2014 I Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dheMarkave eshte nje akt I marre ne kundershhtim me ligjin si nga ana proceduraleashtu dhe material dhe si e tille Gjykata duhet ta shfuqizojte ate dhe te vendosdetyrimin e te paditurit te rregjistroje Marken e kerkuar nga paditesi.

Pala e paditur pretendoi se:

- Kerkesa per kundershhtim eshte paraqur medate 24.6.2014. Theksojmese kerkesa per kundershhtim eshte formulari ligjor i miratuar posacerisht perkete veprim perpara DPPM, e cila ve ne levizje Bordin e Apelimit dhe ajo ne tevertete ne rastin konkret mban daten 24.6.2014.
- Palapaditese ka bere nje citim te rreme te ligjit.Ne te vertete dispozita e referuar me siper. pika 3 e Nenit 153 parashikon shprehimisht se. "Bordi i Apelimit shqyrtton kundershhtimin brenda nje periudhetremujore nga data e paraqitjes te te gjitha argumentave, materialeve dhedokumentave shtese nga palet dhe i njofton ato per vendimin e marre". Nisur ngakjo dispozite pala paditese nuk mund te dale ne konkluzionin se Bordi kashqyrtuar jashte afatit.
- Vetemnga informacioni qe vete pala paditese jep ne kerkese padi del se DPPM kakerkuar pretendime me shkrim prej tyre me date 18.8.2014 (paragrafi III ne fq.2 te kerkese padise), pra supozohet se keto materiale jane depozituar pas kesajdate, pra data e perlllogaritjes se afatit ligjor duhet te verifikohet ngaGjykata bazuar fakte te verteta dhe ne dispoziten perkatese.
- Palapaditese ka pretenduar se: "...njoftimi i ketij vendimi prej te paditurpas afatit dyvjecar nga marrja e tij sjell pasoja shume te renda perpaditesin..." dhe me tej akoma "shpjegon" se "...duke qenese nuk mori nje pergjigje negative brenda afatit te

percaktuar ne Ligj, duke presupozuar se marka e tij ishteregjistruar investoi ne biznes ..." (paragrafi I ne fq. 5 te kerkese padise). •Keto aludime fare te pavlera ne ceshtjen objekt gjykimi tentojne te provojne me kotardhjen e pasojave nga njoftimi i vonuar i Vendimit negativ per kete pale.Themi keshtu, pasi Ligji 9947 e ka te percaktuar hollesisht proceduren eregjistrimit te markes. Keshtu ne rast se Vendimi do te ishte pozitiv (sicpandehu pala paditese) kjo e fundit do te ishte njoftuar per te ndjekur procedurene detajuar te regjistrimit, e cila shoqerohet me njoftim te vecante dhe mepagesen e nje tarife te caktuar shtese. Ne keto kushte kurresesi nuk mund tepretendohet regjistrimi i nje marke nga vonesa e njoftimit te vendimitadministrativ te Bordit.

- DPPMka si kompetence administrimin e markave te paraqitura per regjistrim,shqyrtimin e kriterave ligjore dhe ndjekjen e procedurave per regjistrim, sidhe mbajtjen e regjistrave te markave te regjistruara. Lidhur me vendimet eBordit per pranimin apo mospranimin e kerkesave per kundershhtim te markave qeparaqiten per regjistrim, pasoja/efekti i vetem ligjor qe keto vendime japineshte mbajtja pezull e aplikimit te markes deri ne marrjen e vendimit forme teprere, sic ka ndodhur edhe ne rastin konkret.
- Vendimi objekt gjykimi, edhe sikur te vendoste pranimin per regjistrim te markes separaqitur nga pala paditese, nuk do t'i jepte kurresesi asaj te drejten per taperdorur dhe per te investuar ne biznes, persa kohe qe kompetenca e tij si Bordeshte vetem te pranoje apo te refuzojte regjistrimin e nje aplikimi per marke neregjistrat e DPPM bazuar ne argumentat e paraqitura nga palet dhe kuadrinligjor.
- Ndryshenga sa pretendon pala paditese, investimet ne biznes nuk behet as bazuar nesupozimin e marrjes se nje Vendimi pozitiv te Bordit, dhe as bazuar nepandehmen se marka qenka rregjistruar nga koha e gjate qe ka kaluar. Ketoinvestime behen duke marre parasysht mbi te gjitha parimet e nje tregetari temire, ne kuptim te ndjekjes se parimeve te konkurrences se lire dhe tendershme. Cdo investim i kryer pa i respektuar keto parime eshte i paligjshemdhe si i tille rrezikun per to e mban vete pala qe i ka kryer.
- Nekushtet kur pala paditese ka qene prej me shume se dy vjetesh ne konflikt tehapur me nje subjekt tjetër tregtar per shkelje te te drejtave te markestregtare, del qarte qe ceshtja nuk mund te zgjidhet nga Vendimi i nje organiadministrativ, i cili per me teper nuk e ka kompetencen ligjore per te zgjidhurkete ceshtje tregtare/kriminale te pales paditese qe perdor emer te njejte menje marke te regjistruar (mbajme parasysht ketu legjislacionin tone te perafuarme ate Evropian per mbrojtje te zgjeruar te te drejtave qe rrjedhin ngapronesia intelektuale). Si i tille bie poshte pretendimi absurd per shkaktim tepasojave te renda ekonomike per palen paditese.
- Lidhurme diskutimin e themelit te Vendimit objekt gjykimi deshrojme te sqarojme edhe ketu disa fakte dhe citime te rreme dhe te gabuara te dhena nga pala paditese:
- Imitimii markes se mirenjohur te regjistruar {...} Nr. Regj. 10088 eshte i dukshemdhe i qellimshem sic mund te rezultojte qartazi nga te gjitha krahasimet midistyre. Pra nregjithese se pari pala paditese pretendon se "...market e tijeshte kompleksi i fjaleve "{...} {...}", ndersa markakundershhtuese eshte vetem "{...}" ky pohim nuk eshte i vertete pasi vetepala paditese ka kerkuar perjashtim nga mbrojtja te tjaleve "{...}" siterma pershkruese dhe si elemente qe nuk mund te mbrohen, pasi nuk i japinmarkes asnje vlere

dallueshmerie ne treg.

•Kjoprovohet lehtesisht nepermjet dosjes se aplikimit te paraqitur, si dhe publikimit online te ketij aplikimi. Eshte shume e rendesishme te sqarohet edhe perpara Gjykates pasha e cdo fjale ne marken e kundershtuar. Per analogji do te ishte njesoj sikur mbajtesi i markes se makinave SKODA per shembull. tekerkonte te regjistrohej marka e tij "...E", kur dihet shumemire se tjalet "makine veture" nuk mund te mbrohet nga pronari i Skodes. sepse jane terma qe cdo pronar marke makinash i perdor dhe perbejne pershkrim nefushen e automobilave. Keshtu edhe fjalet "...E" kane nje kuptim te ngjashem dhe perbejne pershkrim ne fushen e hotelerise, (i referohem burimeve te Eikipedia.org; Tripadvisor.com; Cambridge English Dictionary, etj).

•Nekete kuptim marka e pales paditese qe kerkon te regjistrohet ngelet te jetevetem "...E", cka sigurisht qe eshte e njejte me marken e regjistruar me pare nga shoqeria {...} sh.p.k.

•"...Neni 143 i ligjit percakton se marka nuk mund te regjistrohet kur ajo eshte enejte me nje marke tjeter te regjistruar me pare dhe ne rastin konkret nuk kemi te bejme me marka te njejta ne aspektin pamor" (paragrafi I. fq. 6), cka eshte totalisht e pavertete.

•Neni 143 i Ligjit 9947 eshte sigurisht nder dispozitat me te rendesishme te Ligjit 9947. pasi ne te vendosen kriteret se kur nje marke eshte e kundershtueshme, dhe parimi baze i dhene ne te eshte patjeter ai i prevalences se te drejtave temeparshme, dhe me pas ne menyre specifike Ligji percakton konkretisht rastet emundshme te konflikteve lidhur me te drejtat e meparshme.

•Arsyetimii dhene ne kundershtimin tone si pale e trete perpara Bordit te Apelimit kaqene i mbeshtetur kryesisht ne piken 2, germa "b" dhe pika 5. germa "a" te Neni 143, dhe ne keto kushte Gjykata duhet ta mbeshtese shqyrtimin gjyqesor me keto dispozita te cilat nuk parashikojne ate qe pretendon pala paditese, por sa me poshte:

b) eshte e njejte osee ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose tengjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, kuperfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

•Nekete kuptim ceshtja e ngjashmerise midis vete markave objekt shqyrtimi, si dhengjashmeria e sherbimeve per te cilat ato jane/do te donin te ishin regjistruarsic eshte analizuar edhe nga Bordi eshte e padiskutueshme, dhe mbeshtetur nekete arsyetim eshte dhene ne menyre te drejte Vendimi nr. 774/7.

•Deshirojmete sqarojme Gjykatën edhe per nje parim teper te rendesishem ligjor tekeqinterpretuar nga pala paditese. Keshtu ai pretendon se "...per vetenatyren e biznesit ngjashmeria fonetike nuk mund te sjelle asnje konfuzion tek konsumatori, pasi biznesi i paditesit eshte ne nje zone tjeter, jo ne Tirane, ku ndodhet marka kundershtuese, dhe cdokush qe do te shkoje te paditesi se parinuk do te shkoje pasi e konfondon me {...}in ne Tirane, por per shkak tenevojtes te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore etij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra osesherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet;

•Markanuk mbrohet, nese eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te regjistruar, per mallra apo sherbime te njejta ose te ngjashme dhe nese vlefshmeria e saj kambaruar per shkak te mbarimit te afatit te mbrojtjes, per nje periudhe gjashtemujore nga mbarimi i ketij afati.

•Nedallim te thelle me cfare pretendohet ne menyre kaq absurde, ne Neni 3 te Ligjit 9947 eshte percaktuar qarte efekti/parimi territorial i nje marke te regjistruar nepermjet fushes se zbatimit te Ligjit ne tjale. cka do te thote se nje marke eregjistruar ne perputhje me Ligjin 9947 i shtrin efektet brenda territorit te Republikes se Shqiperise. pa e ndare ate neper zona, si ajo e Fierit vec, apo eajo Tiranes vec!! •Njepretendim i tille si ky i dhene nga pala paditese. jo vetem qe eshte absurd dhe papranueshem, por eshte shume i rrezikshem per te drejten e markave tregtare. pasi ne kete menyre rrezikohet qe vete marka {...} te kthehet ne nje fjale pershkruese per hotelerine ne Shqiperi, ku cdo zone mund te kishte {...}in etij. psh {...}i i Tiranes. apo {...}i i Fierit apo {...}i i Korces apotjeterkund, cka perben shkelje flagrante te te drejtes se markes se meparshmete regjistruar dhe te mirenjohur {...} te shoqerise {...} sh.p.k.. Kjomarke eshte e nje subjekti te vetem, shoqerise {...} sh.p.k. i cili ka marreligjerisht te drejten ekskluzive te perdorimit te saj, dhe nga e cila cdosubjekt qe e perdor duhet te heqe dore vullnetarisht apo me forcen e Ligjit.

Arsyetimi ligjor

Shqyrtimi gjyqesor i veprimtarive qeveritare e ka origjinen e vet ne filozofine e shtetit qe qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epersise se ligjit. Ne ditet esotme, nje shtet ligjor nuk mund te mendohet pa akses per te gjitha qytetaret tek nje gjykate e pavarur dhe e paanshme, e themeluar ne baze te ligjit dhe eafte per te permbushur kerkesat e zhvillimit te nje gjykimi te drejte. Si itille, roli i shqyrtimit gjyqesor i veprimtarise administrative eshte te mbrojete drejtat e qytetareve, por edhe te mbrojete interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas ketij roli mbrojtjes, kontrolli gjyqesor shihet si nje mjet i rendesishem ne rritjen e cilesise se administrimit dhe qeverisjes se mire.

Pala e paditur ka refuzuar kerkesene pales paditese bazuar ne nenin 143/2 te ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar : "Refuzimiper shkaqe relative"

1. Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundershtim me te drejtat e meparshme.

2. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur:

a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimeve, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat osesherbimeve, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;

b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cilambrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kureshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republiken e Shqiperise dhe perdorimiose regjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet tepadreja ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme.

3. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajodeklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si:

a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore etij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra osesherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet;

b) te drejten e nje personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e te ciliteshte e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet;

c) te drejtat e pronesis industriale, perfshire emrat e varieteteve tembrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe te treguesve gjeografike;

g) te drejtat e autorit te nje vepre ose te nje pjese te saj, me kusht qe ajo te jete e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nese eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke teregjistruar, per mallra apo sherbime te njejta ose te ngjashme dhe nese vlefshmeria e saj ka mbaruar per shkak te mbarimit te afatit te mbrojtjes, per nje periudhe gjashtemujore nga mbarimi i ketij afati.

5. Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet:

a) marka, me nje, date aplikimi per regjistrim me te hershme sesa data e aplikimit per regjistrim e nje marke tjeter tregtare, duke pasur parasysh, kureshte rasti, pretendimin per prioritet per ate marke, sipas neni 147 te ketijligji;

b) marka, qe eshte regjistruar me pare, nepermjet nje marreveshjes jenderkombetare, ne te cilen Republika e Shqiperise eshte pale;

c) aplikimi per nje marke, sipas percaktimit te shkronjave "a" e "b" te kesaj pike, ne varesi te regjistrimit te tyre;

g) marka, e cila, ne, daten e aplikimit per regjistrim, ose ne, daten eprioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne Republiken e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, tepubliku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimitose reklamimit, ne perputhje me parashikimet e DPPM-se dhe te autoritetevenderkombetare....”

Nga ana e pales paditese jane ngritur pretendime me karakter procedural dhe material: v

Nga pikepamja procedurale:

Palapaditese ka pretenduar se procedimi administrativ eshte kryer ne kundershtim meligjin duke qene se :

- 1) Eshte pranuar nje kundershtim tejafateve te parashikuara nga ligji dhe se
- 2) Vendimi i Bordit te Apelimit i eshtenjoftuar vetem ne date 07.09.2016

ONe lidhje me pretendimin se eshtepranuar nje kundershtim tej afateve te parashikuara nga ligji:

Nga hetimi gjyqesor ka rezultuar sepala paditese ne date 31.12.2013 ka depozituar prane Drejtorise sePergjithshme te Patentave dhe Markave kerkesen per rregjistrimin e markes, permallrat e klases 43 te Klasifikimit te Nises, konkretisht per :*Sherbime per sigurimin e ushqimeve dhepijeve, strehim i perkohshem.*

Pasi aplikimi eshte depozituar ngapala paditese prane pales se paditur ka publikuar ne Buletinin e Markave teDrejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave, me nr.2, date 09.04.2014pamjen e markes se paditesit "{...} {...}" se bashku me te dhenat eplota te aplikimit si dhe klasen 43 te markes ne perputhje me klasifikimin e Nises.

Ndryshe nga sa pretendoi pala paditese kerkesa per kundershtim eshte paraqitur medate **24.6.2014** provuar me formularin eaplikimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dheMarkave.

Neni52 I ligjit nr.9947, date 07.07.2008“Per Pronesine Industriale” i ndryshuar parashikon se:

“Kundershtimindaj nje marke te publikuar depozitohet ne DPPM brenda nje periudhe tremujore nga data e publikimit, kundrejt pageses se tarifes perkatese, nga:

a) *aplikanti inje marke te meparshme te depozituar ne DPPM, ose nga pronari i nje marke temeparshme, regjistruar ne perputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 te nenit 143te ketij ligji; b) pronari i nje emri tregtar, ne perputhje me percaktimin eshkronjes “a” te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji; c) nje personfizik, ne baze te percaktimit te shkronjes “b” te pikes 3 te nenit 143 te ketijligji; g) pronari i nje te drejte te meparshme te pronesise industriale, ne baze te percaktimit te shkronjes “c” te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji; d)gdo person, qe ka te drejten e autorit, sipas percaktimit te shkronjes “g” tepikes 3 te nenit 143 te ketij ligji.”*

Nga same siper ka rezultuar se kundershtimi lidhur me rregjistrimin e markes eshteparaqitur brenda afatit ligjor e perpasoje ky pretendim eshte I pambeshtetur ne ligj.

Ne lidhje me pretendimin perpavlefshmeri te procedures se ndjekur ne lidhje me Vendimi i Bordit te Apelimiti eshte njoftuar vetem ne date 07.09.2016:

Procedurae ndjekur ne lidhje me kerksen per rregjistrim dhe shshqyrtimin e kundershtimitte saj detajohet ne ligjin nr.9947, date 07.07.2008 "Per PronesineIndustriale" i ndryshuar dhe vKM Nr. 1706, date 29.12.2008 "Per Miratimin E Rregullores PerRegjistrimin E Markave Tregtare Dhe Te Sherbimit," i ndryshuar Kjoprocedure ndahet ne dy faza, te cilat jane:

OFaza e pare: Shqyrtimi paraprak idokumentacionit te paraqitur

Faza e dyte: **Shqyrtimi i metejshem i dokumentacionit**

Rregullorja detajon procedure per marrjen ne shqyrtimte kerkesa per rregjistrim marke duke parashikuar ne piken 2 te saj se:

"Ekzaminimi i aplikimit dhe njohja e dates sedepozitimit

2.1 Data e depozitimit te aplikimit per regjistrimin enje marke eshte data kur DPPM-ja merr ne dorezim aplikimin me elementet eparashikuara ne piken 4, te nenit 145, te ligjit.

Ne te kundert, data e depozitimit te aplikimitkonsiderohet data ne te cilen plotesohen kerkesat e pikes 4, te nenit 145, teligjit.

2.2 Nese aplikimi nuk i permbush te gjitha kerkesat enenit 145, te ligjit, dhe kreut II, te kesaj rregulloreje, DPPM-ja njoftonaplikantin per te bere plotesimet, brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit.Periudha per paraqitjen e plotesimeve mund te zgjatet deri ne 1 (nje) muajshtese, nese aplikuesi paraqet, me shkrim, nje kerkesa dhe paguan tarifenperkatese.

Ne gdo rast, kerkesa per zgjatjen e afatit duhet tedepozitohet prane DPPM-se pa mbaruar afati 3- mujor, i caktuar per plotesimin ete metave te kerkeses. Nese aplikanti nuk i kryen plotesimet brenda afatit teparashikuar ne piken 2.2, te ketij kreu, DPPM-ja refuzon te depozitoje kerkesenper regjistrimin e markes dhe i leshon aplikantit njoftimin e refuzimit tedepozitimit....’

Nga hetimi gjyqesor ka rezultuar se Drejtoria e Pergjithshme te Patentave dhe Markaveka perfunduar procedimin administrativ te iniciuar prej paditesit ne daten31.12.2013 me vendimin nr.774/7, date **15.12.2014** , pra pas rreth 1 viti.

Nderkoheky vendim rezulton ti jete njoftuar paditesit vete ne date **07.09.2016** ne kundeshtim me kreu VI te VKM Nr. 1706, date29.12.2008 "Per Miratimin E Rregullores Per Regjistrimin E Markave Tregtare DheTe Sherbimit," i ndryshuar I cili parashikon se:

"2.6 Bordi i apelimit merr vendim lidhur mekundershtimin dhe njofton, me shkrim, palet. Vendimi i bordit te apelimit mundte ankimohet ne gjykaten kompetente administrative brenda 30 diteve nga data emarrjes se njoftimit te vendimit te bordit.’

A do te perbeje zgjatja apo tejakalimi I afateve procedurale shkak per pavlefshmerite vendimit nr.774/7, date **15.12.2014 te Drejtorisee Pergjithshme te Patentave dhe Markave?**

Neni 49 I Kodit te Procedurave Administrative (ne fuqi ne kohen eprocedimit administrativ) parashikonte se:

“1.Progedimi administrativ perfundon brenda nje periudhe kohore prej3-muajsh, me perjashtim te rastit kur parashikohet ndryshe ne ligje te vegantaose kur imponohet nga situata te veganta. Ne rastin e situatave teveganta, progedimi administrativ perfundon 3-muaj pas nderprerjes se situatesse vegante.

2. Mosrespektimi i kufijve kohorete dhene nga paragrafi 1 i ketij neni justifikohet nga organi administrativpergjegjes, tek organi qe vjen menjehere sipër tij ne hierarki, brenda 10 diteve nga perfundimi i afatit 3 mujor ose i nderprerjes se situates sevegante.

Kjodispozite ka per qellim te kufizojë shtrirjen ne kohe te progedimit administrativduke percaktuar afatin e pergjithshem brenda te cilit nje progedimadministrativ duhet te perfundoje. Sipas ketij neni afati i pergjithshem eshte3-muaj por mund te jete edhe i ndryshem ne qofte se ligje te vegantapercaktojne afate te tjera si dhe ne rastet kur zgjatja e ketij afati 3-mujorimponohet nga situata te veganta.

Eshte e qarte se ka raste kur administrata per arsye te ndryshme objektive aposubjektive nuk ka mundesi te respektojë afatin e pergjithshem 3 mujor. Ne katerast ky paragraf vendos nje afat tjeter 10 ditor per te shpjeguar arsyet emosperfundimit te progedimit administrativ. Arsyetimi i veprimeve apomosveprimeve administrative eshte nje parim themelor ne baze te te cilit punonadministrata. Kerkimi dhe dhenia e arsyeve per mosperfundim te progedimitadministrativ eshte thelbesore per percaktimin e pergjegjesive si dhe perpergatitjen e mbrojtjes apo apelimit nga ana e paleve te interesuara.

Gjithsesimosrespektimi i ketij afati nuk passjell pavlefshmeri te vendimarrjes por eshteshkak per pergjegjesi administrative apodisiplinore. Sanksionimi me ligj, i parimit te pjesemarrjes se paleve si nje parimkryesor te procedimit administrativ, ka patur si qellim, qe t'i krijojë ketyrete fundit nje hapësire te konsiderueshme pjesemarrjeje dhe degjimi gjatezhvillimit te procedimit administrativ.

Qellimi i pjesemarrjes se paleve te interesuara ne procediminadministrativ eshte qe ata te paraqesin fakte dhe argumente per te mbrojturpretendimet e tyre, me fjale te tjera te degjohen dhe theniet e tyre te merrenne konsiderate nga ana e organit vendimarrës. E drejta e paleve te interesuaraper t'u degjuar ka nje shpjegim te dyfishte:

Se pari, eshte pjese e te drejtes se personave private per nje gjykim tedrejte ne rastet kur nje autoritet administrativ ndermerr nje procedureadministrative, e cila mund te preke sadopak te drejtat dhe interesat e tij;

Se dyti, ka rendesi per faktin se e ndihmon organin qe te nxjerre nje aktsa me te drejte, pra te beje me te miren e mundshme, pasi vetem ne kete menyreakti do te bazohet ne fakte dhe argumente te vertetuar.

Mosrespektimii ketij parimi ben qe procedura ne leshimin e ketij vendimi denimi megjobe te konsiderohet ne kundershtrim meligjin e per pasoje vendimi i organit publik te deklarohet si i pavlefshem.

Ngaprocedura administrative e realizuarprej Drejtorise e Pergjithshme te Patentave dhe Markave rezulton se janerespektuar te drejtat procedurale si ajo e degjimit apo e njoftimit(pavaresisht se ne vonese).Nga ana e Drejtorise e Pergjithshme te Patentave dheMarkave jane shqyrtuar te gjitha pretendimet dhe kundershtrimet e paleve duke iudhene pergjigje secilit prej tyre.

Nga sa mesiper ka rezultuar se procedura e ndjekur prej Drejtorise e Pergjithshme tePatentave dhe Markave nuk perben shkak qe vendimi nr.774/7, date 15.12.2014 te konsiderohetrelativisht apo absolutisht i pavlefshem.

Nelidhje me proceduren per marrjen ne shqyrtim te kundershtrimit Gjykata cmon sembetet nje element i paqarte dhe i paprovuar ne lidhje me legjitimimin e palesse trete duke iu referuar certifikates se rregjistrimit te markes(paraqitur siprove ne gjykim) dhe vlefshemrise se saj e cila sipas te dhenave te pasqyruarane te i referohet periudhes 25.04.2005-29.10.2014.

Sipasnenit 164 te ligjit nr.9947, date07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" nuk u provuarealizimi i procedures se meposhtme:

"Regjistrimi i nje marke behet per 10 vjet, duke filluar nga data edepozitimit.

2. Marka mund te ripërterihet pafundesisht per periudha dhjetevjegare,pasi pronari depoziton nje kerkese per kete qellim ne DPPM dhe paguan tarifenperkatese, ne nje periudhe jo me vone se gjashte muaj nga data e perfundimit teperiudhes dhjetevjegare te regjistrimit. Ky pretendim nuk iu nenshtrua hetimitgjyqesor dhe per pasje nuk sjell efekte ne shqyrtimin e kerkimeve objekt tekese kerkese padie. **Nga pikempamjamateriale:**

Pala epaditur ka refuzuar kerkesen e paraqitur prej pales paditese duke arsyetuar se:

1."Bordii Apelimit te DPPM, bazuar ne dispoziten e mesiperme ligjore, e perqendroidiskutimin ne tre geshtje kryesore:

a) ngjashmerine mes markave;

b) ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohenmarkat ne konflikt;

c) ekzistencen e mundesise qe te shkaktohetkonfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak tengjashmerive te mesiperme.

a) Ngjashmeriandermjete markave.

Per te bere nje analize te sakte te ngjashmerise ndermjety markave, duhet te merret ne konsiderate teresia e elementeve perberese tetyre dhe pershtypja e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, por dukeu fokusuar me teper ne elementet qe luajne rolin kryesor ne krijimin ekarakterit dallues te markave....

Bordi i Apelimit i DPPM, pretendimin e pales sekundershtuar se ka kerkuar mbrojtje mbi marken vetem si figure, nuk e vleresonte bazuar ne Ligjin Nr. 9947, date 07.07.2008, sepse elementi ljale {...} imarkes nuk i ploteson kriteret e nenit 142 te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008,(i ndryshuar), per te qene element i perjashtuar ne kuptim te dispozitesligjore te sipercituar dhe ne kuptim te kreut IV, pika 1.4, paragrafi i dyte iVKM Nr.1706 date 29.12.2008 "Per Miratimin e Rregullores per Regjistrimine Markave Tregtare dhe te Sherbimit" i ndryshuar. Ne keto kushte, meqenesemarka e kundershtuar permban elemente figure dhe gjithashtu elemente fjale, dote analizohet ne vijim per te dyja keto lloj shenjash te kombinuara ne marke. **Ne aspektinpamor.** konstatohet se marka e meparshme e ka elementin fjale"{...}", ne qender te saj dhe dhe pa ndonje stilizim te vegante, pasi eshteshkruar me shkronja standarde, ngjyre ari, mbi sfond te bardhe. Vleresojme se,ne teresine e emertimit te markes, rolin me te larte stilizues, e luan shkronjaM e cila eshte me e madhe ne permassa sesa pjesa tjeter e fjales.

Perparaemertimit "{...}", gjendet nje element figurativ qe konsiston ne nje burre testiluzuar, me kapele, te ulur.

-Nedallim me marken kundershtuese, marka e mevonshme ne **aspektin pamor, vleresojme seeshte krejt e ndryshme.** Impaktin fillestar ne pamjen e markes e krijonsfondi shume i erret mbi te cilin eshte konceptuar ideja grafike e aplikantitne krijimin e shenjës se tij dalluese. Mbi kete sfond ai ka vendosur elementetgrafike ku perveg fjaleve "{...} {...}"- (ne qender te markes dhe pandonje stilizim te vegante), pjesa qe bie ne sy dhe dominon ne marken ekundershtuar, jane elementet figurative..

Nelidhje me emertimin, ai konsiston ne "{...}"- (elementet fjale-Hotel. Butique **nukmerren ne analize pasi jane elemente pershkruese**, te perjashtuara ngambrojtja ne baze te nenit 142, pika 1/b, te Ligjit Nr.9947, date 7.7.2008, Perpronesine Industriale (i ndryshuar) dhe pikes 1.2 te Kreut IV te VKM nr.1706, date 29.12.2008 -Per miratimin e rregullores "Per regjistrimin e markavetregtare dhe te sherbimit"

Pra, edhe ne baze te instrumentit me te mireklasifikues te elementeve figurative qe njihet sot ne fushen e markavetregtare, i cili eshte Klasifikatori nderkombetar i Vienes, elementetfigurative klasifikohen ne kategori te ndryshme, pra konsiderohen si plotesisht ndryshme.

Sa me siper, gjykojme se **nuk ekziston nje ngjashmerivizuale ndermjet markave**, e tille qe te shkaktoje konfuzion ne treg.

Ne aspektin fonetik elementet {...} ne te dyja markat jane tenjejtja,

Ne kete aspekt **markatjane identike**, pra ekziston rreziku i ngaterrimit te konsumatorit ne lidhje me origjinen tregtare te sherbimeve. Ky perfundim, bazohet edhe ne karakterin e forte dallues te markes se kundershtuar dhe ne reputacionin ne fushen e vet te veprimtarise, te cilin e ka krijuar per shkak te kohes se gjate te aktivitetit dhe cilesise se sherbimeve ne treg.

Ne aspektin konceptual: Eshte e vertete se ideja konceptuale e elementeve grafike e aplikantit te markes sekundershtuar eshte e krejt e ndryshme nga ajo e kundershtuesit, por fakti qe elementi fjale eshte i njejte dhe ka permase te konsiderueshme ne teresine e markes, ngjashmeria konceptuale ndermjet markave ne kete shqyrtim, vleresojmese eshte e konsiderueshme, duke marre parasysh se ne markat e kombinuara fjaleme figure, elementi fjale luan rolin kryesor ne perceptimin e publikut, per arsye se ky element identifikohet edhe vizualisht (shihet i shkruar) si dhe fonetiksht duke u shqiptuar e permendur ne biseda dhe duke u lexuar.

b) Ngjashmeri ndermjet mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt: Mallrat, ne te dyja markat ne konflikt i perkasin klases 43 te klasifikimit te Nises, dhe jane pothuajse identike.

c) Pra, per shkak ngjashmerise ndermjet markave, si dhe te karakterit dallues te markes se kundershtuar, vleresojme se **ekziston rreziku i konfondimit te markave ne treg**"

Vleresimi i Gjykates lidhur me sa me siperperqendrohet pikerisht ne elementet e nmarkes e cila ka kerkuar terregjistrohet dhe verifikimin e kushteve te parashikuara ne nenin 143/2 te ligjit nr 9947, date 7.7.2008, Per pronesine Industriale (i ndryshuar)

Nelidhje me aspektin pamor me te drejte pala e paditur ka arritur nekonkluzionin **snuk ekziston nje ngjashmeri vizuale ndermjet markave**, e tille qe te shkaktoje konfuzion ne treg. Kjo pasi edhe sipas verifikimit me sy te lirete tyre eshte e qarte dalluesmeria mes tyre.

Nelidhje me emertimin, pala e paditur ka pretenduar se :

"aikonsiston ne "{...}"- (elementet fjale-Hotel. Butique duke qene se nukmerren ne analize pasi jane elemente pershkruese, te perjashtuara nga mbrojtja ne baze te nenit 142, pika 1/b, te Ligjit Nr.9947, date 7.7.2008, Perpronesine Industriale (i ndryshuar) dhe pikes 1.2 te Kreut IV te VKM nr.1706, date 29.12.2008 -Per miratimin e rregullores "Per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit"

Nelidhje me kete konstatim Gjykata cmon te perqendrohet ne percaktimin e faktitese keto elemente (Hotel Butique) perjashtohen nga mbrojtja ne baze te nenit 142, pika 1/b, te Ligjit Nr.9947, date 7.7.2008, Per pronesine Industriale (i ndryshuar)

Doktrina ka sqaruar se [\[1\]](#):

"Funksionikryesor i markave eshte qe te dalloje mallrat ose sherbimet e nje personi fizikose juridik nga ato te nje personi tjetere fizik ose juridik. Ne kete menyre same e theksuar te jete karakteri dallues i markes, aq me shume e permbush funksionin e saj marka. Duke marre si kriter karakterin dallues, markat ndahen ne :

vMarka te sajuara

vMarka arbitrare

vMarka sugjeruese

vMarka pershkruese

vMarka te pergjithshme [\[2\]](#)...

Markat pershkruese jane shenja qe zakonisht perdoren ne treg per te pershkruar produktin ne fjale ose cilesi te rendesishme te tij...

Marka pershkruese eshte nje marke, e cila nuk mund te regjistrohet si marke tregtare [\[3\]](#) dhe sie tille nuk gezon mbrojtje ligjore, pasi mbrojtja e shenjave te tilla sjell monopolizimin e perdorimit te ketyre shenjave, gje qe do te ishte e padrejte per personat te cilet prodhojne ose tregtojne te njejtat produkte. Kjo vjen pershkak te faktit se asaj i mungon karakteri dallues, i cili vleresohet ne raportte ngushte me mallrat ose sherbimet. Marka pershkruese thjesht ben njepershkrim te produktit ose te cilesive te tij dhe ne kete menyre markapershkruese nuk percjell asnje mesazh informues lidhur me identifikimin e burimit te mallit ose te sherbimit.

Per shembull ; marka "e embel "eshte shume e mundshme qe te refuzohet per te tregtuar gokollata pasi eshte pershkruese. E njejtja gje vlen edhe per termat cilesore ose lavderues si « I shpejte », « Me i miri » etj.

Megjithate, ne baze te nenit 74 (2)(b), karakterin dallues nje shenje ose kombinim shenjash **mund ta fitoje gjate procesit te perdorimit ne treg**. Nga ky percaktim nuk mund te beje perjashtim edhe nje marke pershkruese, ne qofte se ajo e kalon "proven" e tregut, fiton karakterin dallues dhe pergjon informacion lidhur me identifikimin e burimit te mallit ose te sherbimit, atehere ajo mund te regjistrohet si marke.

Arritja e karakterit dallues domosdoshmerisht kerkon kohe. Kur marka e fiton karakterin dallues permes procesit te perdorimit thuhet

se marka pershkruese gezon mbrojtje ligjore, ecila^[4] nukshtrihet ne rastin e perdorimit korrekt nga palet e treta te emrit, adreses,pseudonimit te tij ose nje treguesi te sakte lidhur me llojin, cilesine,sasine, destinacionin, vleren, vendin e origjines ose kohen e prodhimit temallrave ose te kryerjes se sherbimeve per sa kohe qe ky perdorim nga palet etreta, i permbahet qellimeve te demonstrimit apo informacionit te mirefilltedhe nuk g'orienton publikun lidhur me burimin e mallrave ose sherbimeve. Pra,palet e treta nuk mund te privohen nga perdorimi i zakonshem i ketyre shenjaveqe konsiderohen si marka pershkruese, per sa kohe qe plotesohen dy kushtet eperdorimit te percaktuara ne nenin 83 (3) te ligjit nr.7819 dt.27.04.1994 "PerPronesine Industriale", te permendura melart. Per shembull; Marka « Seeet Candy » eshte nje markepershkruese pasi tregon llojin e mallit qe ajo promovon, por gjithsesi ajo kafituar karakter dallues gjate procesit te perdorimit dhe si rezultat gezonmbrojtje ligjore. Pavaresisht nga kjo, pronari i kesaj marke nuk mund tendaloje perdorimin e saj nga personat e trete, ne rastet kur perdorimi i tyre ipermbahet qellimeve te demonstrimit apo informacionit te mirefillte dhe nuksjell g'orientim te publikut.

Duke iu referuar praktikeseGjykates Europiane te Drejtesise^[5], negeshtjet e bashkuara C-108/97 Eindsurfing Chiemsee Produktions - und VertriebsGmbH (ESC) kunder Boots und SegelzubehorEalter Huber and Franz dhe C-109/97 Eindsurfing Chiemsee Produktions - undVertriebs GmbH (ESC) kunder Attenberger, eshte trajtuar nje nga kushtet qeduhet te plotesoje nje shenje qe te mund te regjistrohet si marke, karakteridallues i saj.....

Gjykata ne trajtimin e ketij rasti ushpreh nder te tjera se :

« ,...nje marke fiton karakter dallues permes perdorimit te saj ne momentin qe markamundeson identifikimin e burimit te produkteve dhe i dallon ato nga produktet eprodhuesve te tjere. Autoriteti kompetent duhet te beje nje vleresim tepergjithshem per te percaktuar nese marka ka fituar karakterin dallues permesperdorimit te saj, ku nje tregues i rendesishem eshte ekzistenca e nje grupi tekonsiderueshem personash qe arrijne te identifikojne burimin e produktit permesmarkes ».

Ngasa me siper Gjykata cmon se elementet pershkrues te markes {...} BoutiqueHotel jane perjashtuar nga shqyrtimi I Drejtorise e Pergjithshme te Patentave dhe Markave ne kundershtim me nenin142/1 b te ligjit nr.9947,date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar sipas te cilit :

"1.Nje shenje nuk regjistrohet si marke nese:

a) nuk ka karakter dallues;

b) **perbehetekskluzivisht nga elemente ose tregues**, qe sherbejne ne treg per tetreguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike osekohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve;..."

Ngaverifikimi I kerkeses se paraqitur prej paditesit si dhe referimit qe I eshte berenga pala e paditur gjate arsyetimit te vendimit (faqe 3 pika IV) arrihet nekonkluzionin se kerkesa e paraqitur prej paditesit I referohet markes "{...}{...}" .

Marka "{...}{...}" nuk perbehet eskluzivisht **nga elemente ose treguesqe** sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren,origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes sesherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo tesherbimeve.

Neketo kushte Gjykata cmon se Drejtoriae Pergjithshme te Patentave dhe Markave duhet te kishte shqyrtuar aspektin fonetik dhe konceptual te markave duke iu referuar te gjithe emerteses "{...}{...}" .

Pala e paditur ka perjashtuar ngashqyrtimi pa te drejte elementet te cilet jane konsideruar pershkrues "*prima facie*" duke e paragjykuar.

Neltali, ne Gjykaten e Modenes^[6], neshqyrtimin e nje geshtje te cybersquatting^[7], utrajtua edhe pretendimi se marka "Miss Italia" eshte shnderruar ne nje marke tepergjithshme, duke humbur keshtu karakterin e saj dallues. Gjykata u shprehender te tjera se: "*Shprehja "miss" eshte emri i pergjithshem kur i referohet jo vetem nje vajze tepamartuar (zonjushje), por edhe fitueses se nje konkursi bukurie dhe keshtupranohet fakti se pjesa e pare e markes eshte kthyer ne nje term tepergjithshem. Megjithate, ne nje rast te tille marka ne teresi perbehet nga njeshprehje e tere "Miss Italia" dhe nje term i tille nuk eshte nje term ipergjithshem*".

Ne kete menyre, jurisprudencaitaliane ka mbajtur qendrimin qe nje kombinim i fjaleve, te cilat ne vetvetejane terma te pergjithshem, mund te kete aftesine te formoje nje shprehjeorigjinale qe karakterizohet nga dallueshmeria.^[8]

Nga sa me siper Gjykata arrin nekonkluzionin se:

Ngjashmeria midis markave (vizuale,orale e kuptimore). Mes markesse rregjistruar dhe asaj qe kerkon te rregjistrohet ka ngjashmeri e cila ekziston per shkak te perfshirjes se :

1) fjales {...}

2) Llojit te sherbimit te ofruar idis dy markave,jane te pabaza.

Ngjashmeria e mallrave (sa me te lidhurame njera tjetren, aq me shume konfuzion shkaktohet). Gjykata mban parasysh se nevleresimin e ngjashmerise midis dy markave, te cilat i perkasin klases 43 te klasifikimit te Nises, dhe jane pothuajse identike. Ne vleresimine faktit te konfuzionit qe mund te shkaktohet **eshte bleresi**. Gjykata cmonse bazuar ne praktiken e deritanishme gjyqesore, ne cdo rast merret ne konsiderate **konsumatori mesatar** per arsye se ruan nje imazh jo perfekte markes dhe ka nje perceptim ne teresi dhe jo ne detaje. Nga analiza e bere, konkluduar drejt se marka tregtare Marka "{...}{...}" perbehet ngashenja dhe aplikohet per mallra qe jane te ngjashme me ato te markes "Mondal"te rregjistruar me pare nga personi i trete por nuk ekziston mundesia e konfondimit per shkak te elementeve dalluessi ne asketin vizual dhe fonetik e konceptual si dhe territorit te ofrimit tesherbimit. Sipasdoktrines:

" Organet e administrates shteterore dallohen **per pavaresine e tyre ne drejtim tevleresimit te rrethanave, kohes, menyres dhe permbajtjes qe duhet te kete aktiadministrativ**, me qellim qe te sjelle sa me mire lindjen, ndryshiminapo shuarjen e pasojave te caktuara juridike. Organet e administrates, ketevleresim e bejne per te sjelle ato pasoja juridike dhe per te arritur ateqellim qe kerkon vete ligji, ne baze te te cilit nxirret akti dhe ne asnjemenyre per te arritur qellime te tjera. Perndryshe ndjekja e qellimeve tendryshme nga ato te vete ligjit, nga ana e organit te administrates shteterorene nxjerrjen e aktit administrativ, do ta bente kete te fundit tekunderligjshem. Nuk perjashtohen ne praktiken administrative rastet, kur ngaana e organit te administrates mund te jene patur parasysh tre kerkesat edomosdoshme qe akti administrativ te kete efekte juridike, pra te jete zbatuarkompetenca e organit, progedura para, gjate dhe pas aprovimit te tij, si dhe tekete patur nje perputhje midis permbajtjes se aktit dhe permbajtjes se ligjit,por megjithate, perseri akti administrativ mund te behet shkak per tukonsideruar i pavlefshem, nese nuk eshte vleresuar drejt dhe sakte qellimi qekerkon te arrije ligji.

Nga sa me siepr Gjykata cmon sevendimi nr.774/7 date 15.12.2014 te Drejtorise sePergjithshme te Patentave dhe MARKave duhet te shfuqizohet duke detyruar palen epadituir te regjistroje marken "{...}Buoitique Hotel ' sipas aplikimit AL/T/2013/774.

- [1] Trajtim teorik dhe praktik i markave tregtare dhe te sherbimit , fq 29 -33,{...}
- [2] Marketing Crafts and Visual Arts, The role of Intellectual Property (A practical guide) (2003), fq.77
- [3] Neni 74 (1) (b) i ligjit nr.7819 dt.27.04.1994
- [4] Neni 83 (3) i ligjit nr.7819 dt.27.04.1994
- [5] Qeshtjet e bashkuara C-108/97 Eindsurfing Chiemsee Produktions - und Vertriebs GmbH (ESC) kunder Boots und Segelzubehor Ealter Huber and Franz dhe C-109/97 Eindsurfing Chiemsee Produktions - und Vertriebs GmbH (ESC) kunder Attenberger
- [6] Codice della Proprieta Industriale, Andrea Sirotti Gaudenzi, fq.134-135, Maggioli Editore, i vitit 2005.
- [7] Me termin "Cybersquatting" njihet dukuria negative e perhapur ne kohet e sotme dhe qe konsiston ne perdorimin ne Internetne menyre te paautorizuar te markave, i cili ndikon ne reputacionin e markes, si dhe mund te sjelle konfuzion tek konsumatorete, duke marre parasysh aksesin egjere qe kane njerezit ne kohet e sotme ne Internet.
- [8] Trajtim teorik dhe praktik i markave tregtare dhe te sherbimit , fq 35,{...}

Per keto arsye

Baza Ligjore Neni 7,11,15/a, i Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreshjeve administrative", Kodi i Procedurave Administrative, Neni 143,152 dhe 153 i Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" . mosmarreshjeve administrative", Kodi i Procedurave Administrative, Neni 143,152 dhe 153 i Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" .

VENDOSI:

Vendosi:

1. Pranimin e kerkese padise.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.774/7 date 15.12.2014 te Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave .
3. Detyrimin e pales se paditur te regjistroje marken "{...}" sipas aplikimit AL/T/2013/774.
4. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.
5. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane .Per palen ne mungese ky afat fillon te llogaritet nga e nesermja e marrjes dijeni per vendimin.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkese padia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}